

MESAZHI I KRYETARIT TË KOMUNËS

I prekur indirekt nga shumë politika të ndryshme, komuniteti ndjente mungesën e një politike konkrete të fokusuar në arritjen e ndarjes së përdorimit të burimeve nga rritja ekonomike. Kështu, si një hap i parë, komuniteti kishte nevojë për një plan zhvillimi strategjik dhe tematik, si ky që hartuam sot, për përdorimin e qendrueshëm të burimeve, veçanërisht burimeve të pa rinovueshme.

Përdorimi i matur i burimeve natyrore dhe njerëzore, hartimi dhe menaxhimi i një plani zhvillimi për një periudhë të gjatë të planifikuar, janë një kusht për zhvillimin e qëndrueshëm të njësisë të qeverisjes vendore, së bashku me begatinë ekonomike dhe një zhvillim social të balancuar.

Sot zonat, njësitë e qeverisjes vendore vuajnë pasigurinë e të drejtave të pronësisë, si dhe mungesën e theksuar të tregjeve të prodhimeve bujqesore, shkatërrimin e infrastrukturës, një pjesë të papunësisë, mungesën e sistemeve formale për sigurinë sociale, mos shfrytëzimin sa dhe si duhet të burimeve e resurseve që ka zona apo komuna.

Ishte nevojë e domosdoshmëri për të bërë një plan zhvillimi lokal afatgjatë, ku të gjenin mbështetjen e tyre banorët e komunitetit, për të përmirësuar nivelin e gjendjes ekonomike – sociale, ndërkohë ky plan e bën njësinë e qeverisjes vendore të jetë e qëndrueshme. Realizimi i planit të zhvillimit lokal u mbështet tek lidhjet e forta me të gjithë komunitetin dhe përçoi një rrugë të re të zhvillimit rural, me ndihmën e pa diskutueshme, që dhanë gjithë grupmoshat dhe organizatat e ndryshme siç ishte në rastin tone FSHZH (Fondi Shqiptar i Zhvillimit), UI (Instituti Urban), URI (Instituti i Kerkimeve Urbane) dhe Mix Tecnic, duke përfshirë këtu dhe një numër të madh njerëzish të trajnuar me aftësi organizative e disiplinore, për hartimin dhe menaxhimin e politikave të zhvillimit lokal, programeve dhe projekteve të përcaktuara në këtë plan konkret zhvillimi. Mendimi mbi zhvillimin rural thekson përjasjen e integruar të bazuar në bashkeveprimet e ngushta midis aktiviteteve të zonave rurale dhe pjesës tjetër të ekonomisë.

Ky dokument i rëndësishëm që u hartua me pjesëmarrjen e shumë aktorëve argumenton se, një zhvillim rural është i qëndrueshëm kur mbështetet fuqimisht në fushat prioritare si zhvillimi ekonomik, infrastruktura, shërbimet, zhvillimi social dhe qeverisja e mire. Situata aktuale dhe prespektiva që jep ky plan i zhvillimit lokal në komunën Maminas, dikton nevojën e administrimit të të gjitha burimeve, duke filluar nga mjedisi që na rrethon, infrastruktura, rritja e prodhimeve industriale, si kompleks i mundësive për arritjen e objektivave të zhvillimit rural të qëndrueshëm.

Ky plan zhvillimi lokal përmirëson efikasitetin e shfrytëzimit të burimeve të të gjitha fushave të veprimt, rrit mjaftueshmërinë ekonomike në përgjithësi, duke rritur konkurrencën dhe i hap rrugë zhvillimit prespektiv.

Ky plan zhvillimi lokal rrit gradën e mbulimit të shërbimeve komunale ndaj komunitetit, biznesit, arsimit, shëndetësisë si dhe rrit nivelin e mirëqenies në të gjitha shtresat e popullatës.

Per hartimin e këtij dokumenti të rëndësishëm falenderojmë: FSHZH, Institutin Urban (Washington DC), Institutin i Kerkimeve Urbane (IKU) dhe Mix Tecnic Tirane.

Ilmi Gjeci
Kryetari i Komunes Maminas

FALENDERIME

Hartimi i këtij plani nuk do të ishte i mundur pa kontributin dhe dedikimin e Këshillit të Komunës dhe të anëtarëve të përmendur më poshtë:

KËSHILLI I KOMUNËS

Shyqyri Mema, Sadik Gjeçi, Telha Zeza, Qazim Koni, Enver Allushi, Selman Alushi, Emin Verjoni, Zuhdi Kodra, Fatmir Gjeçi, Skender Luku, Adem Dervishi, Bajram Lala, Ismail Domi, Nazmi Aliu, Ndrëçim Koni.

KOMUNA MAMINAS:

Grupi i Planit të Zhvillimit Lokal (PZHL)

Kryetari, i zgjedhur nga grupi i PZHL – Naim Leba, (N/Kryetari i Komunës),
Anëtarë të Këshillit të Komunës – Qazim Koni, Ismail Domi, Ndrëçim Koni,
Kujtim Koni, Emin Vrioni, Sadik Gjeci, Adem Dervishi.

Personel nga administrata e komuës–File Barreti, Dilaver Koçi, Dashnor Osmani,
Naim Leba, Qemal Fusha, Bukurie Dervishi, Ali Koni, Ruzhdi Domi.

Banorë me profesione të ndryshme, nga zona të ndryshme të komunës–Fatmira Koni,
Vjollca Vlasi, Emin Dervishi, Lumturi Picari, Xhavit Voci, Sefer Domi, Limon Dervishi, Sabri
Dervishi, Shefqet Domi, Naim Xhepalu, Fatmir Muça, Skender Muça, Reshit Koni, Mersin
Xhafa, Demir Leba, Xhaferr Verjoni, Myftar Domi, Qemal Koni, Sherif Lala, Esat Lala, Zyhdi
Uruçi, Mehdi J. Allushi.

Përfaqësues nga fshatrat: Haki Ramaliu, Ramiz Aruçi, Ylli Thanishta,
Jonuz Voci, Myslym Uruçi, Sabri Leba, Tahir Barreti.

Grupi i Monitorim-Vleresimit me Pjesëmarrje (MVP):

Kryetare – Bukurie Dervishi

Staf i komunës – File Barreti, Bukurie Dervishi

Përfaqësues të komunitetit– Adem Dervishi, Fatmira Koni, Shefqet Lala

Numri total i anëtarëve në grupin e MVP: 5 anetarë

Hartimi i Planit të Zhvillimit Lokal u bë i mundur edhe nga bashkëpunimi i frytshëm me Fondin Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH). Si pjesë e programit të rritjes së kapaciteteve të qeverisjes lokale nën Projektin Punët e Komunitetit II (të financuar nga Banka Botërore), FSHZH përgatiti metodologjinë dhe një strukturë për planifikimin e zhvillimit lokal dhe përzgjodhi komunën tonë si komunë pilote për të testuar këtë metodologji. Gjatë punës së saj, FSHZH përfshiu Institutin Urban (Washington, DC) dhe Institutin e Kërkimeve Urbane (IKU) që të punonte me personelin e FSHZH në hartimin e metodologjisë dhe të monitoronte zbatimin. Në vazhdim të kësaj, FSHZH nënkontraktoi MixTecnica (Tiranë) për të ofruar koordinimin, asistencën teknike dhe monitorimin e procesit të hartimit të Planit të Zhvillimit Lokal në Maminas.

HYRJE

Në 2005 komuna e Maminasit u angazhua në procesin e hartimit të Planit të Zhvillimit Lokal me qëllim që të përcaktonte një vizion të qartë për të ardhmen e komunës - dhe të caktonte hapat e veprimit për të arritur këtë vizion.

Hartimi i Planit të Zhvillimit Lokal u realizua në një proces të hapur dhe transparent duke përfshirë këshillin e komunës, stafin e komunës, grupet e këshillimit dhe të ndjekjes, të krijuara në nivel komune dhe fshati si dhe anëtarë të tjerë të komunitetit në krijimin e një vizioni afatgjatë zhvillimi, objektivave strategjike si dhe hapat/projektet konkrete të cilat do të çojnë komunën e Maminasit drejt zhvillimit të qëndrueshëm.

Pse Duhet të Hartojmë një Plan për Zhvillimin Lokal?

Planifikimi i zhvillimit lokal është një proces që i jep mundësinë komunës sonë — dhe banorëve që ajo përfaqëson — të planifikojnë, zbatojnë dhe kontrollojnë të ardhmen e tyre. Një Plan Zhvillimi Lokal jep informacion mbi drejtimin e veprimeve drejt zhvillimit të një komuniteti. PZHL është një hartë për t'u ndjekur nga të zgjedhurit, personeli i komunës, dhe komuniteti në tërësi për ti dhënë formë të ardhmes së dëshiruar prej tyre. Planifikimi i Zhvillimit Lokal ka të bëjë me të menduarin, të vepruarin dhe të parishikimin strategjik të veprimeve që duhet të ndërmerim në mënyrë që të realizojmë qëllimet e dëshirueshme.

Një plan zhvillimi është efektiv kur ne e kuptojmë se çfare po bëjmë, kujt i shërben, dhe sa mirë i plotëson nevojat e komunitetit. Kur bëhet mirë, planifikimi i zhvillimit lokal ka pjesëmarrjen e gjerë të komunitetit dhe aktorëve të tjerë të interesuar. Kjo garanton që ne po përdorim burimet më të mira të mundshme në planifikimin e së ardhmes ashtu si edhe krijon një forum të gjerë për pjesëmarrje të shoqërisë, përkushtim dhe rritje të ndjenjës së pronësisë.

Qëllimet strategjike dhe hapat e veprimit të shprehura në Planin e Zhvillimit Lokal nuk janë vetëm autoritet i qeverisjes vendore. Komuna nuk mund të bëjë vetë gjithçka, dhe as nuk mund t'i adresojë vetëm të gjitha problemet e komunitetit. Kështu që, në Planin e Zhvillimit Lokal është idea që i gjithë komuniteti ka një kontribut për të dhënë në arritjen e një komune të qëndrueshme. Angazhimi dhe veprimet e komunitetit, grupeve dhe të interesuarve të tjerë janë mjaft të rëndësishme në arritjen e suksesshme të Vizionit të Komunës, qëllimeve dhe veprimeve që janë themelore në Planet e Zhvillimit Lokal.

Një PZHL është efektiv kur në mënyrë rigorozë përdoret që të planifikojë shërbime dhe projekte, identifikojë burimet, boshllëqet dhe nevojat financiare, të masë rezultatet e punës së qeverisë lokale, dhe t'i komunikojë këto rezultate tek komuniteti. Ky është një proces dhe dokument me anë të të cilit komuniteti mund të vërë përpara përgjegjësisë të zgjedhurit në mënyrë që ti përgjigjet nevojave dhe prioriteteve të tij. PZHL siguron një përdorim efektiv të burimeve specifike të komunës në mënyrë që të bëhet sa më e mundur arritja e objektivave.

PER ÇFARE ËSHTË PLANI YNE I ZHVILLIMIT LOKAL?

Nje vizion i Përbashkët

Komuna jone përballet me shumë sfida për zhvillim dhe burime të pakta për ti përballuar ato – por gjithashtu ne kemi shumë mundësi. Detyra jonë është që t'i bashkojmë të gjitha burimet dhe komunitetin në një vizion të përbashkët për të cilin mund të mobilizojmë dhe të përdorim sa më mirë burimet tona njerëzore, natyrore dhe financiare. Për të arritur këtë, procesi ynë për hartimin e PZHL ftoi këshilltarët dhe komunitetin për "të pikturuar" të ardhmen tonë në 10–15 vitet e ardhshme. Rezultati i këtij aktiviteti ishte "**Vizioni i Maminasit**".

Një plan për të Ardhmen Tonë

E ardhmja jonë sigurisht që do të ndryshojë – dhe ne duhet të sigurohemi, që jemi autorë të këtij ndryshimi, duke iu kundërvënë situatave që përcaktojnë të ardhmen tonë. PZHL përmban qëllime dhe hapa veprimi të realizueshme, për të cilat ne jemi të sigurt që mund t'i arrijmë hap pas hapi në rrugën tonë për të përmbushur vizionin.

Katër shtyllat

Ne dëshironim të caktonim një rrjet të gjerë, që të siguroheshim që të gjitha prioritetet e zhvillimit të përfshiheshin në PZHL. Kjo ishte arsyeja që e organizuam PZHL në bazë të katër fushave prioritare:

- Zhvillimi Ekonomik
- Zhvillimi Social
- Infrastruktura dhe Shërbimet Publike
- Qeverisja e Mirë

Një Komunitet, Shumë Zëra

Komuna jonë përbëhet nga shumë zëra – burra, gra, femijë, të rinjë, të moshuar, (pensioniste dhe veteranë), Invalid, fermerë, biznesmenë, e kështu me radhë. Ishte kritike për ne, që të kuptonim shpesh se sa të ngjashme po aq dhe të ndryshme ishin nevojat dhe pritshmerite e këtyre grupeve. Proçesi i PZHL inkurajoi pjesëmarrjen e grave në grupet e këshillimit, dhe të gjithë përfaqësuesit e komunitetit u ftuan që të merrnin pjesë në hartimin e këtij plani.

Komunikimi me Publikun

Plani ynë i Zhvillimit Lokal është një bashkëbisedim me komunitetin. Ne morëm mendime dhe informacion nga komuniteti dhe shpresojmë që këto opinione janë të reflektuara në këto plan. Ne kemi nevojë që të nxisim dialogun dhe opinionin e vazhdueshëm në mënyrë që të sigurohemi që po ndikojmë ashtu siç duhet tek komuniteti ynë.

Një panoramë më e gjerë

PZHL ka të bëjë me të menduarin në terma afatgjatë në lidhje me nevojat e zhvillimit të Maminasit. Sidoqoftë, ne u kujdesëm që të merrnim parasysh edhe Strategjinë Rajonale të Zhvillimit për Qarkun e Durrësit, që të siguroheshim, që ishim në një linjë me Objektivat Rajonale dhe Kombëtare të Zhvillimit për Mijëjeçarin (OZHM). Në këtë mënyrë PZHL i Maminasit kontribon në arritjen e objektivave dhe prioriteteve kombëtare.

KUSH U PËRFSHI NË HARTIMIN E PLANIT TË ZHVILLIMIT LOKAL


Për të pasur një proçes të hapur dhe transparent, në hartimin e planit për zhvillimin e komunës Maminas, është synuar një pjesëmarrje e gjerë nëpërmjet krijimit të grupeve të këshillimit me bazë pjesëmarrjen e komunitetit. Pjesëmarrja e tyre ishte kyç për suksesin e hartimit dhe zbatimit të PZHL.

Grupi i Planit të Zhvillimit Lokal (grupi PZHL): Ky grup është përgjegjës për nxitjen, udhëheqjen, këshillimin dhe mbikqyrjen e hartimit të PZHL. Grupi i PZHL-së së Maminasit përfshiu 55 persona : kryetari i komunës, përfaqësues të këshillit, përfaqësues nga administrata e komunës, përfaqësues të fshatrave si dhe përfaqësues nga komuniteti me profesione të ndryshme.

Nënkomitetet e Fushave Prioritare: Këto grupe përfaqësojnë katër shtyllat kryesore (zhvillimi ekonomik, zhvillimi social, infrastruktura e shërbimet publike dhe qeverisja e mirë) dhe janë përgjegjëse në përcaktimin e hapave të veprimit/projektet konkrete për fushat prioritare dhe hartimin e prefizibiliteteve dhe fizibiliteteve. Këto grupe mund të ftojnë dhe specialistë të tjerë të jashtëm që të japin ekspertizën e tyre në detajimin e hapave të veprimit/projekteve konkrete.

Grupi i Monitorim-Vlerësimit me Pjesëmarrje (grupi MVP): Grupi i MVP-së ngarkohet të punojë ngushtë me grupin e PZHL dhe nënkomitetet për të përcaktuar kriteret, vlerësuar procesin, caktuar matësat për realizimin e objektivave strategjike apo hapave të veprimit. Grupi monitoron edhe zbatimin e PZHL dhe raporton sukseset apo pengesat tek qeverisja vendore (komuna dhe keshilli i komunës) dhe komuniteti. Grupi i MVP përbëhet nga 5 persona që përfaqësojnë administratën e komunës dhe komunitetin.

Figura 1. Diagrama që demonstroi lidhjen midis grupeve të këshillimit



SI E REALIZUAM KËTË PROCËS? DHJETË HAPAT PËR HARTIMIN E PLANIT TË ZHVILLIMIT LOKAL

1. Garantimi i angazhimit lokal. Ky hap siguron që zyrtarët e qeverisjes vendore dhe personeli të njihen me qëllimet e projektit dhe në të njëjtën kohë të angazhohen në këtë projekt. Me 13 Prill, u bë prezantimi i projektit në Këshillin e Komunës së Maminasit. Gjatë këtij takimi u zgjodhën 3 anëtarë të këshillit si pjesëmarrës të grupit të PZHL.

2. Ofrimi i Asistencës. Gjatë këtij hapi u orientuan dhe trajnuan anëtarët e grupit të PZHL dhe MVP për strukturën dhe metodologjinë e PZHL/MVP. Trajnimi 2 ditor u organizua në 10-11 maj dhe përfshiu 27 pjesëmarrës.



3. Fillimi i Punës. Grupet e PZHL-së dhe MVP-së organizuan takime gjatë të cilave caktuan planin e aktiviteteve që do të ndiqnin, si dhe caktuan afatet kohore, rolet dhe përgjegjësitë për çdo anëtar të grupeve. Gjithashtu u organizua një fushatë komunikimi që përfshinte fletëpalosje me informacion për projektin dhe postera për panairët e ideve në fshatra.

4. Mbledhja e informacionit. Përpara se të mësojmë se ku po shkojmë, ne duhet të dimë se ku jemi. Ky hap na lejon të bëjmë një vlerësim të situatës aktuale të komunës dhe të krijojmë një pamje më të plotë dhe të saktë të Komunës. Që këtu mund të fillojmë të mendojmë për të ardhmen e komunës. Kjo fazë ishte shumë e ngjeshur dhe kërkoi përkushtimin e grupit të PZHL. Për shembull, anëtarë të grupit të PZHL plotësuan pyetësozin prej 14 faqesh për karakteristikat e komunës – cilat janë burimet tona natyrore/njerëzore, buxheti i komunës e kështu me radhë. Këto të dhëna u morën në zyrat e komunës dhe në qark.

Bilalas	23
Bodinak	14
Karpen	5
Karreç	29
Maminas	35
Metallaj	15
Rubjeke	52
Vlashaj	9
Total	182

Në anketimin e familjeve u mor informacion nga komuniteti mbi shërbimet që ofron komuna. Anketimi u realizua në të 8 fshatrat e komunës. Familjet u zgjedhen në mënyrë të rastësishme në këto fshatra.


Dhe së fundi, u realizua analiza SWOC me këshillin e komunës në takimin e radhës. Kryetarët e fshatrave u përfshinë në këtë proces dhe dhanë mendime shumë të vlefshme. Analiza SWOC – Fuqitë, Dobësitë, Mundësitë dhe Sfidat – lejoi të zgjedhurit lokal që të jepnin mendimet dhe opinionet e tyre për çfarë shkon mirë në komunë dhe çfarë nuk shkon mirë, si dhe të bënin sugjerime se si mund të përmirësoheshin fushat prioritare.

5. Panairt e ideve në fshatra. Për të marrë opinionin qytetar, përveç anketimit u organizuan nga grupi i PZHL dhe Panairt e Ideve në Fshatra. Panairt e Ideve në fshatra u cilësuan si forume interaktive për të grumbulluar idetë dhe informacionet e banorëve dhe për ta përdorur këtë informacion në hartimin e PZHL. Panairt e ideve u organizuan nga anëtarë të grupit lehtësues të PZHL, grupit të MVP dhe kryetarët e fshatrave.



Panairt e ideve u organizuan në 8 fshatra nëpër vende të hapura, të përshtatshme dhe komode për pjesëmarrësit (Referohu fig. 4). Në komunën e Maminasit morën pjesë nëpër këto panaire 410 pjesëmarrës në total nga të cilët 150 ishin gra dhe një numër i konsiderueshëm të rinjsh të cilët dhanë një informacion shumë të vlefshëm.

Figura 2: Konceptimi i Panairit të Ideve në Fshatra.



6. Sintetizimi i të Dhënave. Me grumbullimin e të gjithë informacionit – profili i komunitetit, anketimi i familjeve, analiza SWOC me këshillin e komunës, dhe panairët e ideve në fshatra - u përgatit nga një paketë informacioni për rishikim për anëtarët e grupit të PZHL dhe MVP. Duke pasur këtë informacion, grupi i PZHL së Maminasit:

- a. Përcaktoi vizionin 10-15 vjeçar për komunën.
- b. Zgjodhi anëtarët për nënkomitetet e fushave prioritare.
- c. Finalizoi objektivat strategjike për çdo fushë prioritare pas propozimeve të Nënkomiteteve të Fushave Prioritare.
- d. Votoi për Vizionin dhe Objektivat Strategjike përfundimtare.



7. Puna e Nënkomiteteve të Fushave Proritare. Ky hap përfshin planifikimin më në detaje të hapave të veprimit për çdo objektiv strategjik të fushave prioritare. Gjithashtu nënkomitetet u ngarkuan me detyrën e hartimit të prefizibiliteteve, që të demonstrohej që hapat e veprimit dhe projektet ishin konkrete, kuptimplotë dhe të realizueshme. Takimet e katër nënkomiteteve të fushave prioritare u kryen në një periudhë kohore prej 3 javësh.




Gjatë kësaj kohe grupi i monitorim vlerësimit me pjesëmarrje punoi me përcaktimin e indikatorëve të cilët u zgjedhën në bazë të aktiviteteve/projekteve që ishin përcaktuar nga nënkomitetet e fushave prioritare. E gjithë kjo punë u prezantua në grupin e PZHL i cili diskutoi planet e veprimit për çdo fushë prioritare, matjen e performancës si dhe hapat në vazhdim. Grupi i monitorim vlerësimit me pjesëmarrje bëri dhe një raportim mbi ecurinë e procesit si dhe sa mirë u arritën pritshmëritë e grupit të PZHL gjatë këtij procesi.

8. Ju Folët ne Ju Dëgjuam, a u Kuptuam Drejt? Takime me komunitetin dhe rishikimi në Këshillin e Komunës: në momentin që grupi i PZHL ka përfunduar draftin e PZHL, ne e prezantojmë atë në komunitet që të sigurohemi, që kjo PZHL i përgjigjet nevojave të tij. Kryetarët e fshatrave luajnë rol kryesor në këtë drejtim.

9. Integrimi me Proçesin e Buxhetit. Qëllimi i PZHL-së është që t'i lejojë komunitetet që të drejtojnë dhe kontrollojnë të ardhmen e tyre. Megjithatë, kjo nuk mund të kuptohet e ndarë nga proçesi i hartimit të buxhetit, pasi ky është momenti kur buxheti i limituar alokohet në ato zëra që ka më tepër nevojë komuniteti. Në hartimin e buxhetit, personeli i komunës paraqet opsione dhe zgjidhje për të zgjedhurit lokal, se si mund të shpenzohen sa më efektivisht paratë e taksapaguesve. Duke administruar të dhënat dhe informacionin nga komuniteti, grupi i PZHL paraqet një panoramë për zgjidhjet e mundshme.

10. Zbatimi dhe Monitorim-Vlerësimi i Vazhdueshëm. PZHL ka një plan të detajuar në të cilin janë përcaktuar afatet kohore dhe përgjegjësitë. Grupi MVP është e ngarkuar me detyrën e monitorimit të progresit që bëhet për arritjen e rezultateve të matshme. Monitorimi do të bëhet rregullisht duke e lejuar grupin e PZHL, të zgjedhurit lokal, dhe personelin e komunës që të bëjnë ndryshime atëherë kur nevojitet. Progresi do të raportohet në komunitet me mënyra të ndryshme – postera, media lokale, buletine informative, fletpalosjedhe nepermjet këshilltareve të komunës.

Figura 3. Struktura e procesit të PZHL



CILI ËSHTË AFATI KOHOR PËR PLANIN E ZHVILLIMIT LOKAL?

PZHL përmban plane veprimesh afatshkurtër dhe afatgjatë. Vizioni përfshin një periudhë kohore prej 10-15 vjetësh. Sidoqoftë, për të qenë sa më realistë dhe të sigurtë që gjërat do të bëhen në mënyrën që duam, e kemi ngushtuar hapësirën e veprimit në 5 vjet. Çdo hap veprimi që paraqitet më poshtë ka një afat kohor për zbatim. Përputhja me këto afate kohore do të monitorohet nga grupi i monitorim vlerësimit me pjesëmarrje.

SI TA LEXOJMË PLANIN E ZHVILLIMIT LOKAL.

Publikimi i Planit të Zhvillimit Lokal përmban këto seksione:

- **Hyrjen** në të cilën shpjegohen qëllimi, pjesëmarrja dhe metodologjia.
- **Profili i komunitetit** që shpjegon në detaje situatën aktuale të komunës duke u bazuar në të dhënat objektive të grumbulluara nga Grupi i PZHL dhe që plotësohet me opinione në lidhje me anketën e familjeve të organizuar në Qershor 2005. Aty ku nevojitet, janë shpjeguar të dhëna nga Strategjia Rajonale e Zhvillimit për Qarkun e Durrësit me qëllim krahasimi.
- **Indikatorët e Performancës** për çdo fushë prioritare do të na lejojnë që të monitorojmë progresin e bërë në arritjen e objektivave strategjike.
- **Të Qënurit në një Drejtim** me Strategjinë Rajonale të Zhvillimit për Qarkun e Durrësit tregon që Maminasi po kontribon në strategjitë e zhvillimit rajonal dhe kombëtar.

AFATET KOHORE NË TË CILAT U HARTUA PLANI I ZHVILLIMIT LOKAL PËR KOMUNËN E MAMINASIT.

Shkurt 05	Maminasi u përzgjedh nga FZSHH një nga 5 komunat pilote për të testuar metodologjine e re të PZHL dhe MVP
Prill 05	FZSHH prezanton konceptin e PZHL tek Kryetari i Komunës dhe tek Administrata e Komunës
13 Prill 05	Këshilli i Komunës voton pro për hartimin e Planit të Zhvillimit Lokal
10 – 11 Maj 05	Grupi i PZHL dhe MVP trajnohen në një trajnim dy ditor.
15 Qershor 05	Përfundon grumbullimi i të dhënave për profilin e komunitetit
Qershor 05	Përfundon grumbullimi i të dhënave nga anketimi i familjeve
6 - 9 Qershor 05	Në fshatrat Maminas, Bilalas, Karreç dhe Vlashaj organizohen panairët e ideve
17-22 Qershor 05	Në fshatrat Rrubjekë, Karpen , Metallaj dhe Bodinok organizohen panairët e ideve
30 Qershor	Organizohet analiza SWOC me Këshillin e Komunës dhe pjesëmarrjen e Kryetarëve të fshatrave
Gusht 05	Takohet grupi i PZHL , hartohet dhe miratohet Vizioni final për Komunën, si dhe caktohen anëtarët e Nënkomiteteve të Fushave Prioritare.
Tetor 05	Nënkomitetet e Fushave prioritare hartojnë Objektivat strategjike
Dhjetor	Grupi i PZHL finalizon Planin e Zhvillimit Lokal të propozuar

INFORMACION I PËRGJITHSHËM PËR KOMUNËN E MAMINASIT

Komuna Maminas shtrihet në lindje të rrethit të Durrësit. Bën pjesë në rajonin qendror të Shqipërisë së mesme.

Toponimia e pasur e zonës, troje, rruge, ura dhe ndërtesa të vjetra, ullinj të shekullorë, deshmojnë për një popullim të hershëm të fshatrave të komunës së Maminasit. Rruget e vjetra që kanë lënë gjurmët e tyre kalonin rreze kodrave Shijak – Shahinaj - Shtraze – Bodinak – Karpen - Maminas – Rrubjekë - Manez - Ishem. Në fund të shekullit XVIII dhe fillimet e shekullit XIX është ndërtuar rruga e vjetër Shilorja që lidhte Tiranën me Shijakun e Durrësin. Po në këtë periudhë është ndërtuar dhe rruga Maminas-Ishem. Në kohën kur sundimi Austriak kishte uzurpuar dhe vendin tone kishte planifikuar të ndërtonte hekurudhën Durrës - Tiranë në segmentin Sukth–Maminas kalonte traseja e kësaj hekurudhe dhe veprat e artit u ndërtuan që në atë kohë si Ura në "Dorben" dhe ura në "Koxhas". Mbi këtë trase të piketuar më parë, në vitet e pushtimit Fashist ky segment u bë rrugë automobilistike dhe rreth viteve 1940-1941 u asfaltua. Kështu që rruga Durrës - Tiranë kalonte tashmë nga Sukthi e Maminasi. Banorët e fshatrave të komunës Maminas qindra vjet më parë kanë ardhur kryesisht nga malesia e Krujës, nga Mati, nga Shengjergji i Tiranës dhe fshatrat e tjera të Tiranës.



Ndër lagjet më të vjetra mund të përmendim lagjen "Lala" (Rrubjeke), Lagja "Domi" në Bilalas, lagja "Koni" Maminas, lagja "Osmani" në Karreç, lagja "Vlasi" në Vlashaj, lagja "Dervishi" në Karpen, lagja "Domi" në Metallaj dhe lagja "Voci" në Bodinak. Fshati Karpen, si toponim është sllav dhe shpjegohet me fjalën gur, pra ka qene shkemb e gur, nga ku për afro 80-90 vjet janë nxjere gure për ndërtimin e rrugëve Shilore, Maminas–Ishëm, Maminas - Sukth, Sukth - Ishem për fshatrat e Shijakut dhe së fundi për NSHN Durrës. Me qëllim të realizimit të këtij aktiviteti ka qene ndërtuar dhe ka funksionuar një teleferik Karpen -Maminas dhe dekovil Koxhasë Vadardhe-Sukth. Të gjithë fshatrat kanë patur xhami e teqe. Në fshatin Rrubjeke, xhamia ka qene e ngritur mbi muret e kishës. Në vitin '37 është bërë një panair i madh kombëtar për fuqinë e fese të sektit bektashjanë e drejtuar nga Sheh Ramazan Picari, i cili ndërtoi një teqe të fortë me famë.

Për shumë vite në ndarjen administrative fshatrat e Komunës Maminas bënin pjesë në Komunën e Prezës, nën prefekturën e Shijakut.

Gjatë viteve fshatrat e Maminasit e rriten nivelin e jetesës, të kulturës, të arsimit. Shkollat e para në këtë zonë janë hapur rreth viteve 1920 si në Maminas "Mitepi", në Metallaj, me vone në Marikaj dhe pas çlirimit me 4 dhjetor 1944 në godinën e ish Kuestures Italiane u hap shkolla e Maminasit dhe me pas vijoi hapja e shkollave në fshatrat e tjera. Në vitet 50'-60' u ngritën qendra shëndetësore dhe të kulturës. Në këtë periudhë dhe në vazhdim u rrit ndjeshëm niveli kulturor dhe arsimor, duke u shkolluar qindra të rinj e të reja në arsimin e mesëm e të lartë. Një tregues më vlerë i arsimimit të kësaj zone është përqindja që zene të arsimuarit me shkolle të lartë ndaj gjithë banorëve kjo e shprehur në përqindje 7% që do të thotë në 14 banorë 1 është me arsim të lartë.

1. SHOQËRIA (Kapitali Social)

a. Komuniteti dhe Dinamika

Lëvizja e popullsisë në Qarkun e Durrësit gjatë 10 viteve të fundit është ndier edhe në komunën e Maminasit. Numri i familjeve (viti 2005) në komunë është 1510 dhe duke u krahasuar me numrin e familjeve në vitin 2000 (1352 familje) shihet se ka një shtim prej 158 familjeve e cila ka ardhur si rezultat i krijimit të familjeve të reja dhe nga migrimi i familjeve nga

zonat Veri-Lindore te vendit. Kjo reflekton dhe tendencën e lëvizjes së familjeve brënda vendit nga zona malore në ato fushore. Familjet e ardhura janë përqendruar kryesisht në fshatrat Rrubjeke, Bilalas, Bodinak, etj.

Nga 6,405 banorë, 8.1% janë pensionistë dhe 14.8% ndjekin shkollën (9 vjeçare dhe gjimnazin). Në përgjithësi nga popullsia aktuale, afërsisht 45.6 % përfaqësojnë popullsinë aktive për punë (të grupmoshës 18-60 vjeç).

Figura 2. Numri i Familjeve në 2000-2005

Fshati	Nr. i familjeve	
	2000	2005
Rrubjeke	331	384
Bilalas	160	173
Maminas	235	260
Karrec	198	219
Vlashaj	110	120
Karpen	118	135
Metallaj	103	115
Bodinok	97	104
Komuna	1352	1510

Në përgjithësi, në komunë ka 2920

persona që janë apo mund të angazhohen në aktivitete për gjenerimin e të ardhurave. Sidoqoftë shkalla e papunësisë në komunë arrin deri në 19.6 %. Këto të dhëna mbështesin edhe prioritetet e komunës për përmirësimin ekonomik dhe shtimin e mundësive për punësim.

Migrimi i popullsisë brënda rajonit, ka rezultuar në shtimin e popullsisë në disa fshatra. Të gjithë fshatrat e komunes kanë mbi 400 banorë. Kjo situatë krijon një mundësi të madhe në forcimin e aktiviteteve ekonomike të këtyre fshatrave si dhe rrit kapacitetet e tyre prodhuese dhe tregtare.

Figura 1. Shpërndarja e Popullsisë

Fshati	Femra	Meshkuj	Gjithsej
Rrubjeke	811	879	1690
Bilalas	362	387	749
Maminas	530	548	1078
Karrec	450	484	934
Vlashaj	244	264	508
Karpen	269	299	568
Metallaj	235	248	483
Bodinok	200	195	395
Komuna	3101	3304	6405



b. Arsimimi



Gjatë shtatë viteve të fundit i është kushtuar një vëmendje e veçantë objekteve arsimore në qarkun e Durrësit, ku janë ndërtuar apo rikonstruktuar shkollat. Në komunën e Maminasit objektet arsimore janë të përqëndruara në tre qendra: Rrubjeke, Maminas dhe Metallaj. Aktualisht Maminasi numëron tre shkolla 9-vjeçare në të cilën mësojnë 725 nxënës dhe ka 54 mësues dhe një shkollë të mesme me 225 nxënës dhe 10 mësues. Në komunë ka dhe 8 kopshte fëmijësh në Rrubjeke, Bilalas, Maminas, Vlashaj, Karpen dhe Metallaj me 183 fëmijë



nen kujdesin e 8 edukatoreve. Përsa i përket arsimit të detyrueshëm 9 vjeçar, raporti është një mësues për 13.5 nxënës.


Figura 3. Shpërndarja e shkollave, nxënësve dhe mësuesve në komunën e Maminasit

Fshati	Shkolla 9-vjeçare	Nxënës	Mësues	Shkolla të mesme	Nxënës	Mësues	Kopshte	Fëmijë	Edukat
Rrubjeke	1	262	16	-	-	-	2	50	2
Bilalas	-	-	-	-	-	-	1	25	1
Maminas	1	388	33	1	225	10	2	53	2
Vlashaj	-	-	-	-	-	-	1	20	1
Karpen	-	-	-	-	-	-	1	20	1
Metalle	1	75	5	-	-	-	1	15	1
Komuna	3	725	54	1	225	10	8	183	8

Situata e përgjithshme, përsa i përket arsimit, duket sikur ka ndryshuar pozitivisht nëse konsiderojmë opinionin qytetar ku vetëm 1.1 % shprehen se janë “te pakënaqur” me gjëndjen e shkollës dhe për kopshtet. 7.7 % e popullsisë shprehen se janë të pakënaqur me kushtet e kopshteve, ndersa 78.6% janë të kënaqur.


Një problem është mungesa e mjeteve dhe pajisjeve shkollore, veçanërisht e laboratorëve duke shtuar dhe nivelin dhe metodat e mësimdhënies, kompetencën e mësuesve si dhe rishikimi i programit mësimor. Këtu nuk mund të flasim për numrin e kompjuterave në shkollë pasi ato nuk ekzistojnë fare.

Në panairët e ideve të organizuar në fshatra gjatë muajit Qershor 2005, komuniteti shprehu një interes të madh në drejtim të përmirësimit të infrastrukturës, që i vjen në ndihmë zhvillimit të arsimit. Komuna e Maminasit i është përkushtuar punës në shtimin e numrit të nxënësve që ndjekin shkollën e mesme, si dhe në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mjeteve mesimore.




c. Kultura dhe Koha e Lirë

Komuna e Maminasit sikurse përmendet dhe në pjesën historike, ka qenë një qendër e njohur dhe e rëndësishme e kulturës dhe me një trashëgimi të pasur kulturore. Megjithatë jeta kulturore e komunitetit nuk është në nivelin e duhur. Komuniteti është i pakënaqur dhe i mungojnë aktivitetet kulturore dhe artistike. Rreth 61.6 % mendojnë se këto aktivitete mungojnë në komunë dhe i njëjti opinion është dhe për aktivitetet sportive. Në lidhje me aktivitetet që organizohen për të rinjtë apo të moshuarit vetë 2.2 % deri 3.3 % shprehen të kenaqur nga organizimi i këtyre aktiviteteve.



d. Shërbimi Shëndetsor

Problemet shëndetsore dhe sëmundjet ulin cilësinë e jetesës së popullsisë dhe në mënyrë të vecantë të fëmijëve. Tranzicioni i vështirë, varfëria dhe ndotja e ambientit kanë ndikuar dhe po ndikojnë negativisht në jetën e banorëve të qarkut të Durrësit. Me gjithë përmirësimin në shkallë kombëtare të disa prej treguesve shëndetsorë, vihet re një rënie e theksuar në cilësinë e shërbimeve shëndetsore, sidomos në zonat rurale dhe informale. Sistemi shëndetsor në komunë përbëhet nga dy qendra shëndetsore dhe 5 ambulanca të cilat ofrojnë shërbime që lidhen me shëndetin e popullsisë që nga lindja e deri në moshën e tretë, përfshi shërbimet para dhe pas lindjes, edukimin dhe ndjekjen e mirërritjes së fëmijës, vaksinimet, diagnostikimin, trajtimin dhe këshillimin në nivel komuniteti të sëmundjeve të ndryshme, referime për në shërbimet e specializuara, planifikimin familjar etj. Domosdoshmeri është riorganizimi i strukturave të shëndetit parësor dhe pajisja e ambulancave me mjetet e nevojshme në mënyrë që të plotësojnë standartet rajonale për zonat rurale. Në të dy qendrat shëndetsore të komunës ka nga një mjek dhe në fshatrat ku ka shërbim ambulancë ka një mjek të levizshëm dhe një personel me nivel të mesëm. Në qendrat shëndetsore dhe ambulancat e Maminasit pothuajse kryhet shërbimi i berjes së analizave mjekësore, ka shërbim dentar (një privat dhe një shtetëror) si dhe shërbim farmaceutik (dy farmaci).



Në përgjithësi komuniteti duket i kënaqur nga kushtet higjenike dhe kanalizimet e ujrave të zeza. Pothuajse 83.5 % e komunitetit shpreh kënaqësi për nivelin e higjenës në komunë në përgjithësi dhe kjo shifër në fshatrat e veçante arrin në 87.3 % .

Ky vleresim i komunitetit përputhet me raportin e përgjithshëm të shërbimit shëndetësor përsëri ku treguesit për qendrën shëndetësore Maminas krahasuar me mesataren e rrethit Durrës janë si më poshtë:


Emertimi i shërbimit	Niveli i treguesit në %	
	QSH Maminas	Rrethi Durrës
Sigurimi i Imunizimit	100	881.8
Kujdesi Antenatal	100	72.7
Planifikimi Familjar	65	63.6
Menaxhimi i rasteve të infeksioneve Respiratore	100	93.8
Menaxhimi i rasteve me Diarreja	100	100
Demtime të vogla	100	90.9
Monitorimi i rritjes së fëmijëve	100	81.8
Asistenca për lindje në shtëpi	0	27.3
Kujdesi stomatologjik	25	18.2
Edukimi shëndetësor	96	81.8
Trajnimi i punonjësve të shëndetësisë	80	63.6
Vaksinimi	100	100

Plani i Zhvillimit Lokal për Maminas, ka përcaktuar disa objektiva dhe hapa veprimi konkrete për përmirësimin e metejshëm të situatës shëndetësore në komunitet, si dhe për atë të mirëmbajtjes dhe përmirësimit të higjenës në teresi për të arritur standartet europiane.

e. Asistenca Sociale



Ka dy kategori njerëzish që përfitojnë ndihmë ekonomike të pjesëshme: familjet pa të ardhura dhe familjet me të ardhura më të vogla se niveli i jetesës.

Komuna e Maminasit numëron 19 familje (1.3%) që përfitojnë ndihmë të pjesëshme sociale, një shifër kjo e vogël gjë e cila tregon se ka nivel të kënaqshëm ekonomik. Sikurse shihet dhe në figurën 7 këto familje janë të shpërndara në 4 fshatra. Pjesa më e madhe e atyre që përfitojnë asistencë sociale ndodhen në Karreç ku numri arrin deri në 13 familje (duke përfaqësuar kështu 6% të numrit total të familjeve në këtë fshat).



f. Cilësia e Jetës

Me gjithë këto sfida në fushën e arsimit dhe shëndetit, në përgjithësi banorët e komunës së Maminasit janë të kënaqur me cilësinë e jetës, 79.1 % e tyre shprehën që janë shumë të kënaqur ose të kënaqur me cilësinë e jetës dhe 83.5 % besojnë se gjendja e komunës ka ndryshuar tre vitet e fundit.



2. Ekonomia

a. Situata e Përgjithshme

Komuna ndodhet 13 km larg portit të Durrësit, 20 km larg plazhit të Gjirit Lalëz, 14 km nga Aeroporti Kombëtar Rinas, 21 km nga ujrat termale në Bilaj.

Avantazhe të tjera të komunës për zhvillim mund të përmendim edhe:

- Ekonomi të vogla por me rendimente të kënaqshme dhe konkurruese.
- Komuna ndodhet ndërmjet dy metropoleve Tiranë–Durrës.
- Përfshihet në zonën e korridorit të 8^{të} nga Durrësi
- Përfshihet në zonën e studiuar të zhvillimit strategjik të rajonit Tiranë –Durrës.

Burimet e konsiderueshme njerëzore e natyrore të komunës mundësojnë plotësisht një zhvillim të qëndrueshëm të komunës së Maminasit. Komuna numëron 3424 banorë që janë forcë aktive për punë që zene (53.4% të popullsisë). Komuna ka një potencial të konsiderueshëm të burimeve njerëzore me arsim të lartë (universitet) dhe arsim të mesëm të profesioneve të ndryshme sikurse tregohet në figurën 10. Një pjesë e mirë e banorëve të arsimuar janë punësuar në sektorin publik.

Figura 10. Shpërndarja e krahut të punës sipas arsimit

Emërtimi	Të punësuar	Të papune
Me arsim të lartë		
Ekonomist	10	5
Agronomë +zootekn	20	10
Inxhinjerë	2	-
Mësues	73	-
Mjek	6	-
Mjek veterinar	5	-
Juriste	4	-
Te tjere	200	20
Shuma	335	35
Arsimi i mesëm	1500	
Shuma	1835	35

Figura 11. Shpërndarja sipas Sektorëve të Punësimit të Banorëve të Maminasit

Lloji i aktivitetit	Sektori Privat		Sektori Publik		Gjithsej	
	Të punësuar	Gra	Të punësuar	Gra	Të punësuar	Gra
Bujqësi , blektori frutikulture	1082	596	-	-	1082	596
Industria perpunuese	19	5	-	-	19	5
Tregtia, riparimi automob.dhe artikujve shtepiak	65	12	-	-	65	12
Hotele dhe restorante	20	4	-	-	20	4
Transporti dhe telekomunikacioni	150	-	4	-	154	-
Aktivite financiare	1	-	-	-	1	-
Administrimi publik	-	-	19	6	19	6
Arsimi	-	-	73	33	73	33
Shendeti dhe veprimtarite sociale	-	-	17	14	17	14
Sherbimi policor dhe ushtarak	-	-	60	2	60	2
Sektori I ndertimit	130	-	-	-	130	-
Sektori i rritjes e zenjes se peshkut	10	-	-	-	10	-
Punesuar jasht shtetit (Itali ,Germani etj)	1200	250	-	-	1200	250
Totali	2677	867	173	55	2850	922

Megjithatë, sikurse përmendet më sipër shkalla e papunësisë arrin në 16.7%. Sektori privat është kryesori për punësimin. Sikurse shihet nga figura 11, aktiviteti kryesor ekonomik është bujqësia dhe blegtoria. 1082 persona, nga të cilat 596 gra janë të punësuar në këtë sektor. Në rritjen e nivelit të mireqenies ekonomike një kontribut të çmuar kanë dhënë dhe japin të punësuarit në emigracion.

b. Blegtoria

Ky sektor, sikurse shihet dhe nga tabela e mësipërme, së bashku me bujqësinë është sektori ekonomik kryesor për komunën dhe numëron 1082 të punësuar. Blegtoria është sektor tërheqës dhe vazhdimisht në rritje për komunën. Kushtet natyrore të komunës favorizojnë rritjen e gjedheve dhe sigurisht duke qënë një zonë fushore ka kushte të favorshme edhe për shtimin e shpendëve. Numri i krerëve në përgjithësi ka ardhur duke u rritur. Ky zhvillim mund të shpjegohet me disa fakte si: kërkesa në rritje për produkte blegtorale, shtimi i sipërfaqeve me foragjerë (ekzistenca e tokave për kullotë), shpenzime jo të mëdha për mbareshtimin e gjësë së gjallë, si dhe përshtatja e fermës së vogël për të rritur ato. Figura 12 na jep një pamje të numrit të gjësë së gjallë në komunë.

Viti	Të imta		Gjedhë	Shpendë
	Dele	Dhi		
2005	457	185	1939	9100

Megjithëse prodhohet shumë mish, pikat e përpunimit të mishit në komunë mungojnë dhe aktualisht komuna ka pesë therrtore. Ka vetëm një pike për grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e qumështit në fshatin Bilalas, por këto pika nuk i plotësojnë nevojat e fermerëve në komunë, të cilët kanë përmendur si prioritet ndërtimin e një baxhoje të re dhe moderne në komunë. Një nga problemet kryesore të zhvillimit të blegtorisë mund të përmendim përmirësimin racor, përmirësimin e strukturës së të ushqyerit, krijimi i kushteve të përshtatshme higjieno-sanitare, dhe rritja e numrit të krerëve në çdo fermë. Tabela 13 na jep një ide më të qartë për produktet dhe sasinë e tyre që prodhohet në komunë.

Delet		Dhitë		Lopët		Shpendët		
Mish kv	Qumësht kv	Lesh kv	Mish kv	Qumësht Kv	Mish kv	Qumësht kv	Mish kv	Vezë 000/kokra
13	823	23	7	333	400	35448	55	1650

c. Bujqësia

Karakteristikë e komunitetit është kultivimi i perimeve e foragjereve dhe zgjerimi gjithnjë në rritje i sipërfaqes së vreshtave, pemtorëve dhe ullishteve, dhe në zonat kodrinore kultivimi i barbutit së hershme dhe i bostanoreve.

Të dhënat më të hollësishme për tokat sipas studimit të fundit të bonitetit të ndara sipas përbërjes së tokës flasin qartë për kushtet shumë të favorshme për një bujqësi ku mbizotërojnë rendimente të larta e kosto e ultë e prodhimit bujqësor.

Toke Bujqësore (ha)			Pyje (ha)	Ullishte (ha)	Te tjera (ha)
Ara (ha)	Pemishte (ha)	Vreshta (ha)			
1514	205	23	425	206	596.7



Kjo zonë ka edhe resurse të tjera favorizuese për ushtrimin e veprimtarive të tjera të karakterit bujqësor si: vreshtarinë, olivikulturën (kultivimi i ullirit), pemtarinë, foragjeret, dhe në zonat kodrinore duhanin.



Toka bujqësore, ze nje sipërfaqe prej 1949.9 prej te cilave toka ara 1515 ha, pemishte 205 ha ,vreshta 23 ha , ullishte 206 dhe 425 ha pyje te cilet jane kryesisht dushku, lisi, frasheri, akacie, pishe, plepi i bardhe, dhe shkurre te tilla si mare, shqope, shkoze.

Sipërfaqja e teritorit të komunës gjithsej është 2969.7ha.

Ndryshimet në politikat e bujqësisë ndikuan ne orientimin e prodhimeve në komunë ashtu sikurse në gjithë qarkun e Durrësit. Prodhimet kryesore të komunës tregohen në figurën 15.

Drithëra			Produkte bujqësore			Fruta ullinj (t)	Vresht (t)
Grurë (t)	Misër (t)	Thekër (t)	Të ndryshme (t)	Patate (t)	Fasule (t)		
330	195	-	2900	770	100	245	160

